



# REPUBLIKA E SHQIPERISE

## KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë – ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2268 email : keshilli@lezha.org

### VENDIM

Nr 66 datë 19.12.2007

#### MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2008 PËR BASHKINË LEZHË

Bazuar ne ligjin nr. 8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nenet 16 e 32, në ligjin nr 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" si dhe ne ligjin nr 8560, date 22.12.1999 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqipërisë" me ndryshimet e mevonshme, me propozim te nje grupi keshilltaresh, Keshilli i Bashkise Lezhe;

#### VENDOSI:

##### Neni 1:

Me perjashtim te rasteve kur eshte shprehur ndryshe, termat e perdorur ne kete vendim kane te njejtin kuptim qe ato kanë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" si dhe ne ligjin nr 8560, date 22.12.1999 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqipërisë" me ndryshimet e mevonshme.

##### Neni 2:

Per efekt te zbatimit te paketes fiskale per vitin 2008, teritori i bashkise Lezhe, ndahet ne dy zona:

**Zona A** : Perfshin teritorin qender e qytetit me kufizimet si me poshte: Nga Semaforet deri tek Ura e Cenit (Rruga Luigj Gurakuqi perfshire edhe lokalet net e djathte ne breg te Lumit Drin, Ura e Cenit – Gurra ( lokali i Nikoll Vilajetit) lagja Gurra poshte rruges kryesore qe kalon ne qender te lagjes; lokalet qe ndodhen ne te dy anet e bulevardit Gjergj Fishta deri tek semaforet si dhe te gjithë lokalet e aktivitetet e tjera brenda teritorit te kufizuar nga vija i magjinare e sipercituar.

Ne kete teritor perfshihen edhe lokalet e aktivitetet e tjera ne rrugen nga Libraria Kuvendi deri tek shtepia e ushtarakeve e pjesa e aktiviteteteve ne rrugen qe përshkruan mepërmes lagjen Skenderbej deri tek ura e vjeter mbi Lumin Drin.

**Zona B**; Perfshin të gjithë aktivitetet qe ndodhen ne teritorin e bashkise jashte zones me kufizimet e sipershenuara (**Zona A**).

##### Neni 3:

Niveli i taksave sipas kategorive dhe nenkategorive, agjenti tatimorë, këstet e pagesës, madhësia dhe koha e pagimit përcaktohen si më poshtë:

#### 3.1. Taksa vendore mbi biznesin e vogel percaktohet:

ne 000/lek

Nr	Niveli xhiros	Deri 2000		2000-3000		3000-4000		4000-5000		5000-6000		6000-7000		7000-8000	
		A	B	A	B	A	B	A	B	A	B	A	B	A	B
	<b>EMERTIMI AKTIVITETIT /ZONA</b>														
1	Shitje me pakice	25	18	48	34	63	44	78	55	93	66	108	76	123	87
2	Shitje me shumice	25	18	48	34	63	44	78	55	93	66	108	76	123	87
3	Prodhim	23	17	45	32	60	42	75	53	90	63	105	74	120	84
4	Sherbime	20	14	43	31	58	41	73	50	88	62	103	73	118	83
5	Profesione te lira	30	21	53	40	68	48	83	60	98	69	11	8	128	90
6	Ambulant	5	4												

**3.1.1. Per automjetet e transportit te udhetareve, taksa paraqitet si me poshte:**

000/ lek

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 5 vende	20
2	Automjete 6-9 vende	40
3	Automjete 10-25 vende	42
4	Automjete 26-42 vende	45
5	Automjete mbi 42 vende	48

**3.1.2 Për automjetet e transportit të mallrave, taksa paraqitet si më poshtë:**

000/lek

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 2 ton	28
2	Automjete 2-5 ton	40
3	Automjete 5-10 ton	48
4	Automjete 10-16 ton	50
5	Automjete mbi 16 ton	75

**3.1.3 Per mjetet e transportit ujore:**

000/lek

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Transport detar brenda vendit	50
2	Transport me liqene brenda vendit	40
3	Varka per shetitje	12

3.1.3 Kjo takes paguhet ne kater keste të barabarta, në afatet e mëposhtme;

- Kësti parë jo më vonë se data 20 prill
- Kësti dytë jo më vonë se data 20 korrik
- Kësti tretë jo më vonë se data 20 tetor
- Kësti katert jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

3.1.3 Përfitojnë lehtësi tatimore në masën 20% ato biznese që bëjnë pagesën e plotë vjetore Brenda datës 31 mars të vitit fiscal në vijim.

3.1.4 Agjent tatimorë për vjeljen e kësaj takes është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

3.1.5 Kunervajtjet administrative, sanksionet dhe e drejta e ankimit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006

### 3.2 Taksa mbi ndertesat.

Llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së ndërtimit në pronësi të taksapaguesit, përfshirë sipërfaqen mbi e nën tokë ose për çdo kat.

Nivelet treguese të taksës mbi ndertesat përcaktohen si më poshtë:

Lek/m<sup>2</sup> në vit

Nr	KATEGORIA OSE NËNKATEGORIA	NIVELI i TAKSËS
1	Ndertesë banimi	
•	Ndertuar para vitit 1993	10
•	Ndertuar gjatë ose pas vitit 1993	12
2	Ndertesë të tjera	
•	Për shërbime arsimore, shkencore e socialkulturore	105
•	Për shërbime private shëndetësore	120
•	Për shërbime administrative dhe profesionet e lira	130
•	Për tregti me shumicë e pakicë dhe shërbime të tjera të të gjitha llojeve	150
•	Për ndertesë në shërbim të aktivitetëve prodhuesë e përpunuesë në të cilat janë punësuar mbi 20 veta	21
•	Për ndertesë në shërbim të aktivitetëve prodhuesë e përpunuesë në të cilat janë punësuar 10-20 veta	30
•	Për ndertesë në shërbim të aktivitetëve prodhuesë e përpunuesë në të cilat janë punësuar deri 10 veta	35
•	Ndertesë në shërbim të OJF dhe tejet të amortizuara e jashtë funksionit ekonomik	25

3.2.1 Sipërfaqja në pronësi të çdo subjekti tatimpagues përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për objektet që mungon një dokumentacion i tillë kjo sipërfaqe përcaktohet me komision të posaçëm, i cili ngrihet e funksionon me vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi bazën e kërkesës e informacionit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Brenda datës 31 mars 2008.

3.2.2 Kjo taksë paguhet në dy këste të barabarta, në afatet si më poshtë:

- Kësti i parë brenda datës 30 qershor
- Kësti i dytë brenda datës 30 tetor

3.2.3 Përfitojnë lehtësi tatimore në masën 10% të vlerës së detyrimit të gjitha subjektet që bejnë pagesën e plotë vjetore brenda muajit prill.

3.2.4 Agjent tatimorë për vjeljen e kësaj takes është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

### 3.3 Taksa e fjetjes në hotel.

Paguhet nga klienti që strehohet në hotel dhe shënohet në faturën e hotelit si zë me vehte. Mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë dhe derdhet në favor të saj çdo datë 5 të muajit pasardhës.

Masa e kësaj takes është 5% e çmimit të fjetjes.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Lezhë çdo muaj duhet të rakordojë me subjektet përkatëse për derdhjen e taksës si dhe të ushtroje kontrolle sistematike për dokumentimin e saj prej tyre.

### 3.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja:

Përcaktohet mbi bazën e vlerës në lek të ndërtimit të ri e koeficientëve në përqindje si më poshtë:

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	KOEFIENENTI NE % NDAJ VLERES SE NDERTIMIT	
		ZONA A	ZONA B
1	Objekte banimi	1,5	1
2	Objekte sherbimi e tregtie	3	2
3	Objekte arsimore, shendetesore, shkencore, administrative e socialkulturore	2	1,5
4	Investime ne i nfrastruktore	1,5	1
5	Për aktivitete prodhuese	1	0,8

Kjo takes paguhet nga i nvestitori ne nje kest ne momentin e leshimit te lejes se ndertimit. Agjent tatimore per mbledhjen e kesaj takes eshte KRRT-ja e Bashkise Lezhe.

### 3.5. Taksa për zënien e hapësirave publike.

Kjo takes percaktohet mbi bazen e siperfaqes ne meter katrore te zena nga subjekte te ndryshme per qellime biznesi dhe dhe nivelit te saj per meter katrore si me poshte:

- Zenje e hapesires publike per qëllime biznesi ne tregjet publike te administruara nga bashkia 90 lek/m<sup>2</sup>
- Zenie e hapesires publike per qëllime biznesi jashte vendit te tregtimit (njesise) me vendosje e reklamim mallrash, vendosje tavolinash, kufizime e rezervime te çdo natyre 117 lek/m<sup>2</sup>

3.5.1 Paguesa e kesaj takes behet me keste mujore me parapagim ne momentin e lidhjes se kontrates me bashkine Lezhe.

3.5.2 Agjent tatimore per vjeljen e kesaj takes jane Drejtoria e Sherbimeve dhe Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

3.5.3 Zenia pa leje e hapesirave publike dhe moskryerja e pagesave paraprake si me siper denohet si kundervajtje administrative sipas legjislacionit ne fuqi. Drejtoria e Sherbimeve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake ushtrojne kontrole periodike lidhur me zenien e hapesiarve publike per qëllime tregtimi.

### 3.6 Taksa e tabelës.

Percaktohet si detyrim vjetor ne lek i subjekteve mbi bazen e kategorive dhe nenkategorive te meposhtme:

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	Taksa ne lek	
		ZONA A	ZONA B
1	Tabele i dentifikim aktiviteti ne gjuhen shqipe		
	• Per subjektet fizike	500 lek/vit	350 lek/vit
	• Per subjektet juridike	1000 lek/vit	800 lek/vit
2	Tabele i dentifikim aktiviteti ne gjuhe te huaj	3000 lek/vit	2000 lek/vit
3	Tabele per reklamim malli fikse ose e levizshme		
	• Tabela te zakonshme dhe te përbëra	8000 lek/vit	6500 lek/vit
	• Tabela elektronike	10000 lek/vit	7000 lek/vit

Ky detyrim paguhet ne nje kest ne momentin e marrjes se lejes per vendosje, kurse per çdo vit brenda dates 20 prill.

Agjenti tatimore per mbledhjen e takses se tabelës eshte Drejtoria e taksave dhe Tarifave Vendore.

### **Neni 4. Taksa e perkoheshme e gjelberimit dhe ndriçimit.**

Kjo takes paguhet nga tatimpaguesit sipas percaktimit te kategorive, nenkategorive e nivelit te meposhtem:

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	Taksa ne lek	
		ZONA A	ZONA B
1	Kategoria familjare	200	100
2	Kategoria biznes		
	• Ambulantet	1000	500
	• Subjektet fizike	2000	1000
	• Subjektet juridike	4000	3000
	• Institucione private arsimore, shkencore, shendetesore, sportive, administrative etj.	3000	1500

Pagesa eshte vjetore dhe kryhet me nje kest brenda dates 31 mars ose ne momentin e regjistrimit te aktivitetit fillestar.

Agjent tatimore per vjeljen e kesaj takes jane Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Sherbimeve.

## Neni 5

### Tarifat vendore.

Llojet, kategorite, nenkategorite, baza, kestet, koha e pageses dhe organi qe ngarkohet me mbledhjen e tyre percaktohen si më poshtë:

5.1. Tarifa e pastrimit dhe e largimit te mbeturinave.

Kategorite, nenkategorite dhe nivelet e tarifes shprehen ne lek/vit dhe jane si me poshte:

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	Taksa ne lek/vit	
		ZONA A	ZONA B
1	<b>Kategoria familjare:</b>		
	• Familje qe ne te ardhurat e tyre kane vetem pensione, familje ne ndihme ekonomike, familje me kryefamiljar invalid, veteran te luftes apo qe ka statusin e jetimit.	400	200
	• Familje te tjera	1.000	500
2	<b>Kategoria biznes:</b>		
2.1	<b>Njesi tregtimi</b>		
	• Bulmet, mish, peshk, ushqimore	30.000	20.000
	• Industriale, veshmbathje, kancelari, mobileri etj	15.000	10.000
	• Magazina e tregti me shumice	40.000	30.000
2.2	<b>Njesi sherbimi:</b>		
	• Bar kafe, i nternet kafe, pube	20.000	15.000
	• Restorante, fast-foode, piceri, byrektore, pasticeri etj.	40.000	30.000
	• Diskoteka, lojera fati etj.	35.000	25.000
	• Pika servisi automjete	40.000	30.000
	• Elektroshtepiak, kasetofona, foni, sallone bukurie(parukiere), rrobagepesi etj.	15.000	10.000
2.3	<b>Njesi prodhimi</b>		
	• Prodhim e tregtim tulla, blloqe betoni, gelqere, i nerte biznesi i vogel	25.000	15.000
	• Prodhim e tregtim tulla, blloqe betoni, gelqere, i nerte biznesi i madh	50.000	25.000
	• Prodhime e perpunim druri, hekuri, duroalumini etj. Biznesi i vogel	20.000	15.000

•	Prodhime e perpunim druri, hekuri, duroalumini etj. Biznesi i madh	40.000	30.000
•	Prodhime ushqimore, buke, mish, peshk, bulmet biznesi i vogel	30.000	20.000
•	Prodhime ushqimore, buke, mish, peshk, bulmet biznesi i madh	50.000	30.000
•	Thertore, perpunim e tregtim vajrash, nafte, gazi e nenprodukte, shtypshkronja etj.biznes i vogel	20.000	12.000
•	Thertore, perpunim e tregtim vajrash, nafte, gazi e nenprodukte, shtypshkronja etj.biznes i madh	35.000	25000
2.4	Subjekte ndertuese		
•	Per selite administrative	20.000	10.000
•	Per ndertimin e objekteve te reja (kantiere ndertimi) deri 3 kate	30.000	15.000
•	Per ndertimin e objekteve te reja (kantiere ndertimi) mbi 3-5 kate	50.000	25.000
•	Per ndertimin e objekteve te reja (kantiere ndertimi) mbi 6 kate	100.000	70.000
2.5	Profesionet e lira, i nstitutionet arsimore, shendetesore, kulturore e sportive private	8.000	6.000
2.6	Hotele, motele, komplekse turistike, zyra administrative etj te ngjashme me to ne lek/dhome/vit	500	300

Perjashtohen nga pagimi i kesaj tarife i nstitutionet dhe bizneset qe kane nje sherbim te vetin per largimin e mbeturinave apo nje kontrate me sipermarres privat per nje gje te tille si dhe i nvalidet, te verberit e te semuret para e tetraplegjik

Pagesa per kategorine familjare behet ne dy keste te barabarta ne keto afate:

- Kesti i pare brenda dates 30 qershor
- Kesti i dyte brenda dates 20 tetor

Per kategorite e tjera detyrimi paguhet ne nje kest brenda dates 20 prill ose ne momentin e lindjes fillestare te detyrimi.

Të ardhurat e siguruara evidentohen ze me vete dhe perdoren vetem per permiresimin e ketij sherbimi.

Agjente tatimore per mbledhjen e kesaj takes jane Drejtoria e Sherbimeve dhe Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

## 5.2 Tarifa e parkimit te automjeteve.

Per parkimin e automjeteve ne vendparkimet publike me pagese percaktohen tarifat si me poshte:

Nr	Kategoria e automjeteve	Tarifa ne lek sipas kohes se parimit	
		Lek/1 deri 3 ore	Parkim i rezervuar/vit
1	Autobusa	200	10000
2	Minibusa	100	6000
3	Autovetura	50	3000
4	Kamione deri 3,5 ton	100	5000
5	Kamione 3,5-8 ton	150	6000
6	Kamione 8-16 ton	200	10000
7	Kamione mbi 16 ton	200	15000
8	Automjete me rimorkjo, trailera		

etj.	300	20000
------	-----	-------

Agjent tatimore per vendet e rezervuara eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kurse per parkimet e perkoheshme me pagese kontraktohen punonjes si agjent tregu te cilet perfitojne 10% te takses se grumbulluar.

### 5.3 **Tarifa per sherbimet administrative:**

#### 5.3.1 **Sherbimi i arkives.**

- Dokument vertetim pronesia 200 lek
- Ekstrakt vendim keshilli e vertetime te tjera 100 lek

#### 5.3.2 **Tarife sherbimi per tregjet publike:**

- Shites artikuj i ndustrial 1.000 lek/muaj
- Shites artikuj ushqimore 1.500 lek/muaj
- Shites artikuj bulmeti e mish 2.000 lek/muaj

Pagesa e menjehershme e kesaj tarife sjell uljen e saj ne masen 10%.

Agjenti tatimore eshte punonjesi qe ndjek shfrytezimin e tregut publik, sipas kontrates me bashkine Lezhe.

#### 5.3.3 **Per dhenjen e licensave perdoren tarifat si me poshte:**

- Dhenje certifikate transport mallrash e pasagjeresh 2.000 lek
- Dhenje autorizimi e konfirmimi per transport nderqytetas 2.000 lek
- Licensa per servise, lavazhe e parkingje automjetesh 5.000 lek
- Autorizim shitje karburanti me pakice 50.000 lek
- Leje per sherbim me orar te zgjatur apo 24 oresh 10.000 lek

#### 5.3.4 **Tarifa ne fushen e urbanistikës**

- Pranim dosje per shqyrtim per te gjitha aplikimet per nevoja biznesi 5.000 lek  
per shtepi banimi 2.000 lek
- Terheqje dokumentash te njesuar me origjinalin nga arshiva teknike dhe ajo e kadastres urbane 100 lek/dokumenti
- Kontroll i piketimit te objekteve 5.000 lek  
Kontroll i piketimit te objekteve shtepi banimi 2.000 lek
- Kontroll pas perfundimit te themeleve 5.000 lek  
per shtepi banimi 2.000 lek
- Kontroll pas perfundimit te karabinase 1.500 lek/kat
- Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues pas perfundimit te punimeve 1.000 lek
- Akt kontroll i perfundimit te punimeve per leje shfrytezimi:  
objekte deri 5 kate 8.000 lek  
objekte mbi kate 8.000 lek + 1000 lek/kat mbi 5
- Fotokopjim planshetash ne shkallen 1/500; 1/200  
format A4 100 lekë  
format A3 200 lekë  
format A2 400 lekë  
format A1 1.000 lekë  
format A0 2.000 lekë
- Azhornim genplanesh per leje ndertimi 40 lek/m<sup>2</sup>; per procedure legalizimi te shtesave ne objekte me leje 30 lekë/m<sup>2</sup>; ne objektet e vecuara 10 lek/m<sup>2</sup>
- Genplan i paazhornuar format A4=1000 lek; format A3= 2000 lek
- Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit, azhornim i genplanit 3000 lek
- Azhornime per reklama e zenie hapësirash public 2.000 lek
- Dhenie certificate per firmat e ndertimit 500 lek

Per grumbullimin e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e urbanistikës.

#### 5.4 Tarifa te i nspektoriatit veterinarë:

- Çertifikate nderkombetare eksport lekure, bretkosa, kermij, peshk 2.500 lek/rast
- Çertifikate shoqerimi qen, mace, produkte shtazore per perdorim vetjak 500 lek/rast
- Kontroll i produkteve me origjine shtazore 1.000 lek/mjet
- Kontroll e leshim raporti ne njesi prodhimi te produkteve e nenprodukteve te mishit e qumeshtit 200 lek/rast
- Çertifikate lejim konsumi te peshkut e produkteve te detit 2.000 lek/rast
- Vulojsja e mishit dhe paisja me raport veterinar per kafshet e trasha 150 lek/krere
- Vulojsja e mishit dhe paisja me raport veterinar per derrat e kafshet e i mta 100 lek/krere

5.4.1 Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet i nspektoriatit veterinar.

#### 5.5 Tarifa sherbimi per institucionet e varesise:

5.5.1 Drejtoria e Muzeut Historik. Hyrja ne muze behet me bileta ne vlerat e meposhtme:

- Femije 50 lek
- Te rritur 100 lek

5.5.2 Pallati i Kulturës “Manush Alimani”:

- Salla e leksioneve 3.000 lek/ora
- Salla e madhe 20.000 lek/ora
- Per shfaqjet me hyrje te lire per publikun 200 lek/person

5.5.3 Klubi shumesportesh “Beslidhja”:

a) Ndeshje kombetare:

- Tribuna A e B ( e mbuluar) 400 lek
- Tribuna A e B e pambuluar 300 lek
- Tribuna perball 200 lek

b) Ndeshje nderkombetare:

- Tribuna A e B ( e mbuluar) 500 lek
- Tribuna A e B e pambuluar 400 lek
- Tribuna perball 300 lek

c) Per dhenien ne shfrytezim te mjediseve sportive tarifa eshte 50.000 lek/aktivitet

5.5.4 Ngarkohen per mbledhjen e ketyre tarifave administrata e institucioneve vartese, si dhe drejtoria e finances per evidentim e kontroll.

#### 5.6 Ne qendren e zhvillimit dhe edukimit te femijeve do te aplikohen tarifat e meposhtme:

- Frekuentim kopshti 30 lek/dite/femije
- Frekuentim çerdhe 20 lek/dita/femije

5.6.1 Familjet qe kane me shume se nje femije perfitojne uljen e kesaj tarife me 50% per femijen e dyte dhe 100% per femijen e trete.

5.6.2 Perjashtohen nga kjo tarife femijet me aftesi te kufizuara, sipas percaktimit mjekesor; femijet me statusin e jetimit, femijet qe kane per kryefamiljare gruan-nene e femijes, femijet e lindur jashte martesë qe jetojne me nenat e tyre, femijet me prinder me aftesi te kufizuara, te verber, para e tetraplegjike.

#### **Neni 6**

Per tatimpaguesit me vendndodhje ne zonen periferike te qytetit, administrate e bashkise te negociroje e ngreje komisione te perbashketa me komunat fqinje. Ne rastet kur nuk arrihet marreveshje te veprohet sipas percaktimit te nenit 4, pika 6 te ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 duke ju drejtuar gjykates brenda tremujorit te pare te vitit 2008.

#### **Neni 7**



Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Sherbimeve, e Urbanistikes, Drejtoria e Burimeve njerezore dhe drejtuesit e institucioneve vartese

**Neni 8.**

Policia bashkiake ngarkohet te mbeshtese sipas rregullave te percaktuara ligjore i inspektoret e tatimeve dhe drejtorite e zyrat e tjera ne realizimin e te ardhurave nga taksat e tarifate vendore.

**Neni 9**

Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes, ne perputhje me nenin 33 te ligjit nr 8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2008.

**KRYETARE  
ROZA HILA**